

## **Prof. Dr.Valentina Sinaj**

Prof.Dr.Valentina Sinaj është pedagoge e brendshme në Departamentin Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar FEUT, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune mbi 20 vjeçare si pedagoge dhe studiuese në Fakultetin e Ekonomisë. Pas diplomimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës dega Matematikë 5-vjeçar në Korrik 1999, ka ndjekur Studimet Master në Administrim Biznes (2001-2003) në bashkëpunim me Universitetin e Nebraska-Lincoln, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Univeristetit i Tiranës, Doktor i Shkencave në "*Matematikë, Statistikë, Informatikë*" (2009), në prill 2012 ajo ka fitur titullin Profesor i Asociuar dhe mbas qershor 2016 mban titullin Profesor. Studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me modelime matematikore dhe Ekonometrike në fushën e ekonomisë. Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë apikime të matematikës në ekonomi si dhe modelimeve Ekonometrike. Është anëtare e Këshillit të Përhershëm për gradën doktor të Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës mars 2019-mars 2021.

Anëtare e Këshillit të Profesorëve të Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës Shtator 2016- dhjetor 2018. Anëtare e Këshillit drejtues të Shoqatës së Matematikës Shqiptare (AMA) që prej dhjetor 2017. Anëtare e Bordit drejtues Shqiptar dhe kordinatore e Konkursit Ndërkombëtar Kangaroo që prej janar 2018. Anëtare e European Women in Mathematics (EWM) dhe kordinatore për Shqipërinë që prej janar 2019. Deputy Leader për EGMO 2020, European Girls' Mathematical Olympiad.Holland. Anëtare e bordeve Editoriale dhe anëtare si reviewer në revista shkencore të Huaja si dhe anëtare e bordeve shkencore në konferenca ndërkombetare. Ajo është autore dhe bashkautore e disa tekseve si Ekonometri, Probabilitet dhe Statistikë, Ushtrime dhe problema matematike për maturën shtetërore, më shumë se 30 artikuj, më shumë se 50 kumtesa konferencash dhe shumë materiale të tjera kërkimore dhe projekte Aktualisht Anëtare e Senatit Akademik, UT.